

ALBAN TUFA
NISHANET NË FORMË L-JE
ROMAN

BOTIMET TOENA

ALBAN TUFA

NISHANET NË FORMË L-JE

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-376-02-2

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

Besjanës, me krejt dashurinë që s'e rrëfej dot...

Kur e pashë trupin e babës të mbërthyer në atë arkë drejtkëndore, tek rrëshqiste teposhtë litarëve, edhe puthte gjithnjë e më afër dheut, m'u bë sikur përnjëmend krejt historia e njerëzimit po zhytej nën tokë. Kur na vdesin gjyshërit na vdes një pjesë e mirë e historisë. Por kur na vdesin edhe prindërit lidhjet me të shkuarën shpëputen krejtësisht. Tekefundit kur nuk ke babën as lidhjet me të shkuarën nuk kanë se ç'mutin të duhen.

Nëse më pyesin tani se çfarë mban mend rreth vdekjes së babës nuk e di sesi mund të përgjigjesha. *Qofshi shnosh! Zoti e pastë çue në xhenet! Kryet shnosh! Ju pastë lënë jetë ju!* Kujt? Mua, apo mamës? Mama aty afër është, sidomos tani që s'e ka as babën. Mua një mut më vlen tash jeta. Pa A. Vreshin, dhe pa babën nuk vlen as një dysh. Por sido që të jetë, jeta nuk është transaksion që t'ia shpiem dikujt teprinë.

Çfarë mund të bëjë tashmë një burrë kur baba i vet nuk është më? Do të mundohet të bëhet si ai. Si me thënë t'i zërë vendin.

Në Shterpë, historikisht kur dikujt i vdiste baba, pas do ditësh e merrte *kryefamiljarllëkun* djali. Së pari merrte kutinë e duhani dhe fillonte ta pinte me të dredhme siç e pinte rahmetliu, nga i njëjti duhan. Mandej i zinte vendin në krye të odës. I zinte vendin nëpër konakët e Shterpës dhe Grykës së Drinit. Po nuk qe i martuar, duhej ta bënte sa më shpejt, se kështu e ka burrnia, e burrat e pamartuar nuk janë burra, por veç djelmosha të papjekun. Kur vdes baba, djali është vazhdimi i tij në këtë botë, si me thënë fija ende e pashkëputur krejtësisht. Kështu, djali në mënyrë graduale i rikujton nasihatet e babës, e duke i praktikuar këto vetë, fijet krejt të holla me babën zënë e trashen aq sa nuk vihet më re mungesa e tij.

Ai është i pranishëm me krejt këshillat që ka pas dhënë, me historitë që ka pas treguar dhe me krejt veprimet që ka pas bërë. Pas vdekjes baba shndërrohet në *hitin* e diskurseve familjare.

Unë e doja babën, madje dhe pse është sot nën dhé, vazhdoj ta dua ende, po njësoj, po njëtrajtshëm, veçse sa qe gjallë nuk i thashë kurrë se e doja, jo se nuk desha, jo se nuk e kisha çuar nëpër mend, por për shkak se ai nuk më tha kurrë se më donte, qoftë edhe njëherë të vetme. Ndoshta dashuria mes burrash nuk duhet të ekzistojë, ose ndoshta në familjen tonë dashura ishte bombë, dhe se nuk ka më shkatërruese sesa ndjenja. Kësisoj, baba ka qenë një pehlivan, dhe e ka ditur shumë mirë se dashuria bashkë me ndjenjat janë shkatërruesi i marrëdhënieve familjare,

gjë të cilën nëse vërtet e ka menduar kështu, ia ka fut pordhës.

Te prindërit vepron në mënyrë të çuditshme një forcë mistike. Pikërisht, kur atyre iu afrohet vdekja, fillojnë dhe flasin për të. Fillojnë dhe e mësojnë veten me vdekjen. Kështu bëhen më të butë, më të ëmbël, sikur janë të bindur që Zoti lart, do t'i mbajë shënim vetëm ditët e fundit të jetës. Zënë e shqetësohen për fjalën e mirë në publik, për imazhin e mirë që do të lënë në katund, për marren dhe për turpin, për veten dhe fëmijët.

Pikërisht kështu foli edhe baba tri ditë para se të vdiste. Foli për ndërrimin e çatisë, e bashkë me të foli për turpin, për marren dhe për vdekjen e vet, ama nuk ia qëllloi dot shkakut dhe rrethanave, sepse edhe pse ai tha që mund ta zinte brenda çatia e shtëpisë, pra një vdekje nga jashtë, ajo i erdhi nga brenda, ngaqë për një çast zemra i pushoi së punuari dhe meqë iu bë më mbarë ashtu duke pushuar, nuk iu rikthye më punës: atak kardiak.

Që nga ai çast unë fillova t'i ngjaj babës. Fillimisht u bëra i fortë si ai dhe nuk qava. Mandej u bëra kryefamiljar dhe i mora motrat e vëllain në telefon; i njoftova se baba kishte ndërruar jetë dhe ata duhet të ishin të nesërmen për në varrim. Por me sa duket unë për ata nuk isha baba dhe nuk ma pjerdhën hiç lajmërimin tim; asnjëri nuk erdhi. Sakaq njoftova fisin sipas zakoni, katundarët e Shterpës dhe krejt miqtë e babës, siç do të kishte bërë vetë baba, ose siç tekefundit kishte bërë kur vdiq gjyshi.

I prita siç do t'i priste baba dhe nuk iu lashë gjë mangët. Në faljen e xhenazes u rreshtova në safë të parë, mu pas imamit, siç do të bënte baba nëse do të falej xhenazja ime. Kur i përcollëm njerëzit nga varrimi, unë isha i pari në rresht siç mund të kishte qenë baba në varrimin tim dhe të gjithë ma dhanë dorën siç mund t'ia kishin dhënë babës në varrimin tim.

Varrin ia rregullova me duart e mia dhe vijën e majës ia drejtova së bashku me podillat prej dërrase, siç do të kishte bërë baba nëse do të ishte varri im. Në shtëpi pritëm e përcollëm njësoj siç do të kishte përcjellë baba në varrimin tim.

Edhe Selim Vreshi më ngushëlloi siç do të kishte ngushëlluar babën në varrimin tim:

- Kryet shnosh!

Edhe A. Vreshi më solli një mesazh gjoja ngushëllimi, njësoj siç mund t'ia kishte dërguar babës në rastin e varrimit tim.

Këtu e kuptova që bashkë me babën, atë ditë, kisha vdekur edhe vetë. Pak a shumë, ose në pjesën time më të madhe.

I

Kohët e fundit kanë filluar të më ndodhin gjëra të çuditshme. Kështu, meqë nuk kam me kë t'i ndaj, do t'i ndaj me ty. Nuk e di sesi mund të quhet një bllok shënimesh që nuk mban shënime përditë, por sidoqoftë unë do ta quaj, thjesht, bllok shënimesh.

I nderuar Zoti Bllok Shënimesh!

Sot po nis të shkruaj mbi ty, ose mbi faqet e tua historinë e çuditshme! Historinë e parë të çuditshme. Ndodhi para dy ditësh.

Lejomë fillimisht, Zoti Bllok Shënimesh, të prezantohem. Jam Artan Tula. Nuk është nevoja të ta them, por po e bëj për mirësjellje i nderuar Bllok Shënimesh, unë lexoj shumë letërsi dhe sigurisht shkruaj. Dëshiroj të jem një shkrimtar i madh, por ç'e do, jam nga fshati Shterpë. Një fshat i thellë në grykën e Drinit. Pak a shumë siç janë dhe njerëzit e këtij fshati, shterpë. Prandaj kam frikë se nuk do të bëhem shkrimtar, sepse nuk ka asnjë të tillë nga ky fshat. Të gjithë këtu bëhen bujq.

Mblidhe tash kurrizin tënd të lëmuar o Bllok Shënimesh, shtrëngohu dhe ndieje çfarë do të shkruaj mbi ty!

Më duhet çdo ditë të kullos lopën. E bëj me kënaqësi. Herë-herë marr ndonjë libër me vete. Kur nuk marr libër me vete mendoj, o për të krijuar ndonjë ngjarje, ose për të medituar mbi romanet që lexoj. Pardje lopën e kullota nga Gungat edhe pse mama më porositi ta çoja në rrafshe. Nuk dua të më përzihen në punën time sublime të kullotjes së Kuqes.

Po kënaqesha duke e parë lopën tek hante. Kuqja ime i mbështillte fijet e barit me gjuhën e saj të gjatë, siç mbledh kosa fijet e jonxhës, e mandej me një sistem të përpiktë përthithës shtynte barin e këputur në depozitën e saj gjigante. Kjo lopa ime është një fshesë e madhe me korrent, mendoj. Ç'mekanizëm, them me vete! Në këtë mahni e sipër, pres e pres që barku i saj të mbushet. I mbledh ajo fijet e barit të gjendura tufa-tufa rrëzë arës së misrit, dhe herë pas here ngre kokën e saj sa një sënduk dhe këput degë të imëta lajthish. Aq sa të imëta mund të kenë mbetur në këtë fundshtatori.

Përtej gardhit të rrugicës së Gungave shfaqen arat e arta të misrave gati në të pjekur. Në Shterpë misrat piquen vonë, ngaqë Shterpa është vend i ftohtë. Edhe pse në buzë të Drinit, fryn një erë që të këput me tërësej. Ka raste kur misrat në arë ende të paprerë i zë bora e parë. Sigurisht kjo borë nuk mban gjatë, dhe me t'u shkrire fshatarët turren me ngut, i presin e i

vjelin arat e misrit për dy-tri ditë. Siç po shkruaja, ende janë të papjekur dhe nuancat e tyre prej ari i japin Shterpës një pamje mahnitëse.

Kuqes sime nuk i bën aspak përshtypje kjo pamje. Ajo ka një natyrë të thjeshtë, madje asaj veç i mjafton të ketë për të mbushur barkun me bar. Herë-herë e hedh vështrimin nga kallinjtë e misrit, por i bën përshtypje veç ngjyra e kallinjve. Tenton për të disatën herë ta zhysë kokën në gardh e të kapë qoftë edhe një gjysmë kalliri, por unë bëj atë për të cilën jam aty, e tërheq. Ajo krejt e mërzhitur dhe me brirët e saj të prehtë si kangjella portash hekuri, i kthehet sërish barit.

Krehja e pastaj shkulja që Kuqja i bën jeshillëkut krijon një ritëm të ëmbël zhurmash. Gërzhitma e saj përzihet me fësh-fëshet që dalin nga fërkimi i gjetheve gjysmë të thara të misrit, duke krijuar melodinë më të bukur që mund të prodhojë natyra. Aq sa shtohet veriu nga gryka e Drinit drejt Shterpës, aq më shumë rritet edhe zëri i melodisë së dalë nga misrat. Por tashmë era ka mehur, dhe si për çudi njëfarë melodie ende vazhdon të burojë nga ara jonë e misrit. Ndalem dhe mbaj vesh. Gjuha e gjatë e Kuqes nuk më lë të dëgjoj qartësisht se ç'zhurmë buron prej misrit. E gjuaj Kuqen me shqelm turinjve për t'ia ndalë të ngrënit dhe zhurmën. Mbaj sërish vesh. Diç më qartë dëgjoj. E dalloj zhurmën, por sërish e kam të pamundur ta kuptoj me saktësi se çfarë e shkakton.

Mendja më shkon beftë te ndonjë ari. Më rrëqethet trupi. Gjunjët më këputen. U dha në lajme, para disa

ditësh, që matanë Drinit fshatarët kishin vrarë tre arinj të murrmë, pasi i kishin gjetur në arat me misër tek bënin kërدينë. Jo. Nuk ma merr mendja që arinjtë të kenë kaluar Drinin. Ata nuk dinë not. Ose mund të dinë. Jo nuk dinë. Not dinë vetëm arinjtë polarë, këtë kemi mësuar në lëndën e biologjisë. Këta tanët dinë një presh. Po sikur të kenë kapërcyer lumin nëpërmjet urës? Të jenë aq të zgjuar arinjtë? Zakonisht për zgjuarsi nëpër fabula përmenden vetëm dhelprat. Përnjëmend më bëhet të iki. T'ia shkel vrapit, drejt e në shtëpi. Ku ta lë Kuqen? Hedh vështtrimin në arën e misrit dhe shoh te pesë-gjashtë kashta, bash mu në mes, që pahiten në një ritëm të rregullt, sikur po i lëviz dikush me dorë.

Arinjtë i bëjnë këto lojëra. Thonë se arinjtë para se ta kollofisnin gjahun, fillimisht luajnë me të. Prandaj ai qen bir qeni luan me misrat e arës sonë.

Ti thërras babait?! Jo. Më kot. Shtëpia është larg. Ndoshta nja 2 kilometra. Zëri im sado i fortë të jetë nuk i përshkon dot kilometra të tëra. Po ti provoje, i them vetes. Ja e provove, thotë, dhe babai të dëgjoji, por ai që do të mbërrijë i pari tek ti, nuk do jetë babai, por ariu dora vetë. Nuk më pëlqen as kjo ide.

I thërras mendjes edhe njëherë. Kuvendoj mundësitë më të mira, dhe e vetmja zgjidhje është të iki në heshtje. Ashtu me Kuqen për dore të kthehem në shtëpi. Aty t'i tregoja tim ati, e së bashku me të, me çiftin në dorë ta rrëzojmë përtokë armikun e arave tona, gjithnjë nëse do të ketë qëndruar derisa ne të kthehemi.

Sa bëj të iki, më kujtohet im vëlla. Ai ka shkuar të kthejë kanalin e ujit për të vaditur për së fundmi herë jonxhën që gjendet fill pasi mbaron ara me misër.

Im vëlla është dy vjet më i madh se unë. Gjithë verën e ka kaluar me shat në krahë. Vadit misra e vadit jonxha. Kjo është hera e fundit për këtë vit dhe mund të jetë fatale me një ari që sillet nëpër misër duke bërë akrobacira me kashtat e pathara ende mirë. Nuk e lë tim vëlla të përleshet me një ari. Maksimumi që mund të bëj është të pres. Të pres gjersa ai të kthehet, e krejt nën zë t'i tregoj që në misrin tonë gjendet një ari gjigant. Fundja kaq mund ta bëj. Zoti ari mund të vazhdojë të luajë me kashtat e misrit, të bëjë cirk brenda, mjaft që mos e kuptojë që dy qenie përtej gardhit po e përgjojnë, njëra as nuk do t'ia dijë, e tjera po shurret në brekë prej frike.

Ndërkohë prek pantallonat. Dora më laget dhe një duhmë e ngrohtë ngrihet deri te fytyra ime. Ujë më janë bërë tutat fëshfëshe me logo *Adidas*. Nuk kanë punuar aletet. Mjetet e mia djaloshare nuk e paskan bërë punën siç duhet. Qenkan dorëzuar të gjitha veç trurit. Trurin e kam top. Krejt të kthjellët, si ky qiell i kësaj mbrëmjeje.

E habitshme sesi truri i njeriut kur gjendet përballë rrezikut funksionon në mënyrë të përpiktë, a thua se njeriu është lindur, e sakaq stërvitur të veprojë, me tërësej nën kushtet e rrezikut. Frika është gjeneratori më i mirë i punës së trurit. Sigurisht ai që ka tru të shëndoshë ka edhe frikë. Ai që ka mend e njeh frikën,

thonë të vjetrit. Këqyre se si Kuqja ime rreh me gjuhë
fijet e barit dhe nuk i kërcet as për ariun, as për frikën,
e madje as për trurin.

Ashtu krejt lagur prej ujit të burimit tim, ulem te
kanali, që kalon rreth gardhit, dhe me atë pak ujë që
rrjedh laj dorën, mandej tjetrën e në fund fytyrën. Uji
është i ftohtë e më jep një freski të beftë. Sikur ma
kthjellon edhe më pamjen, sikur ma ndrit edhe më
mendjen. Çohem.

Zgjatem në majë të gishtave, aq sa ato mund të
mbajnë, për të parë nëse ariu vazhdon ende të lëvizë
me shputat e tij të mëdha kashtat e misrit. Dhe,
sakaq nuk zhgënjehem. Ende luajnë në të njëjtin
kah, veçse, diç më dendur, diç më ngulmët. Zëri i tij
mban një ritëm të butë, dhe të paqartë. Është një zë
i papërcaktueshëm. Herë më ngjan si zë ariu, herë
zë njeriu. Ndoshta këto dy qenie ngjasin më shumë
sesa duket me njëra-tjetrën, së paku në zë. Ç'iu desh
këtij dreq ariu në arën tonë?! A pak toka ka fusha e
Shterpës? Pse nuk shkoi ta zëmë, në arat e Selimit?
Selimiiiiit...?

Hedh vështtrimin poshtë në arat e Selimit, me
shpresën që ariu aty ka me ç'të ngopet: lopën laramane
që e shoqja e tij e lidhi sot pas dreke. Tentoj ta shoh
edhe qosheve, pasi në mes të arës nuk rrok dot gjë,
por ajo nuk është.

- Pthuu! Budalla! Nuk është ari o teveqel, është
lopa e Selimit. Ajo po bën kërدينë në misrin tënd.

E lidh Kuqen time në mes të rrugës në një degë
thane nga gardhi i arës. E lidh një dysh që mos
zgjidhet e t'u turret edhe ajo kallinjve të misrit.
Kapërcej gardhin në një shteg të ulët. Shtyj me
bërryl disa degë ferrash dhe me trupin kërrusur, gati
këmbadoras, futem në rreshtat e parë të misrit.

Jam i bindur se ajo që po bën kërدينë në mes të
arrës është lopa e Selimit. Së paku ajo nuk ka brirë,
tekefundit çjerrë s'më ka dot. Sapo ta rrok për litari,
do ta marr dhe do ta çoj në shtëpi; do t'ia tregoj babait
dhe pastaj të vijë Selimi bashkë me Selimavicën
e ta marrin. Madje le të marrin edhe cucën e tyre
flokëdredhur me vete. Po e deshën lopën, sigurisht.
Të gjitha shenjat me mend më shpiten te lopa, dhe
sigurisht që ajo do të jetë. Por se ç'kam një frikë, asi
të vockël, krejt minimale. Po sikur të mos jetë lopa e
Selimit? Ç't'i bëj një ariu unë, i vetëm, me këtë trup
thatim, me këtë lëkurë të zverdhur, ose me këto tuta
të lagura nga shurra ime? Gajret Artan Tula! Flokët
biondë kaçurrela të së bijës së Selimit kanë një çmim.
Kape lopën, shko e lidhe në shtëpi; e mandej çoji
fjalë Selimit. Ose shko vetë drejt e në derë, dhe thirr
o Selim Vreshi. Pa ç'zë i ëmbël e i butë do të dalë nga
dritaret, ç'zë melodioz do të të thotë: Hajdeee! Veç
kur ta shohësh të bijën e Selimit tek del në shqeme
të derës duke hapur me dorën e imët perden prej tyli.
Ka çmim bukuria. Ec, lopa po bën kërدينë në mes të
arës!

Lëviz pa u ndier nga rreshti në rresht duke i kaluar misrat si të jem një akrobat, krejt delikatesë e butësi. Pa zhurmë afrohem drejt vendit ku po ndodh kërdua. Pas misrave më shfaqen konturet e errëta të lopës së Selimit. Vrapoj. Vrapoj dhe beftë ndalem. Silueta e saj e errët ka marrë ngjyrë blu. Nuk kam parë kurrë në jetën time një lopë blu, as në televizor madje. Lopë jo e jo, por as ari blu s'kam ndeshur ndonjëherë. As edhe një kafshë me ngjyrë blu nuk më kanë parë sytë.

Zhurma është shumë më e qartë. Edhe pamja po ashtu. Dy zëra dihasin me ëh-e-ah. Të dhjefsha sytë o Artan Tula, nuk është lopë, i them vetes, e aq më pak ari. Janë dy njerëz sipër njëri-tjetrit. Janë ngatërruar keqas, sikur po bëjnë mundje, kimboks, a xhudo, ose diçka të tillë.

I shoh krejt kureshtje. Ata kapërthehen me njëri-tjetrin. Hyjnë e dalin te njëri-tjetri. Unë i shoh krejt i përthyer. Dihasin. Bëjnë zhurmë. Ndërrojnë mënyra. Ndërrojnë tingujt. Rrah t'ua shquaj fytyrat, por zor e kam. Nuk më lënë kashtat e misrit të shoh tej. Të afrohem kam frikë, ose diçka të tillë, të iki s'mundem dot. Se ç'më lidh me këtë pamje se rrok dot. Sakaq diç më ngatërrohet nëpër këmbë. Ashtu nëpër të lagurat e tutave ndiej të ngjallet ndërkaq krejt beftë mjeti im djaloshar. Pikërisht ai që pak minuta më parë u lëshua me tërësej. Nga pamje e çuditshme zë e më shndërrohet në një pamje pak a shumë të bukur, shumë të bukur, mahnitëse, tërheqëse. Ç'më gjeti kështu?! Xhindet! Të më kenë zaptuar fantazmat? Ruajna Zot!

Ndërkohë zëri i tyre më hyn në vesh dhe më tej nëpër trup. Për një çast zëri iu rritet. Në kulm. I të dyve. Me aq sa shquaj njëri ngjan si burrë, tjetri si grua. Tani i shquaj më mirë. Janë pikërisht burrë e grua. Zëri tash iu bie. Gjithçka mehet. Gjithçka fiket

- Po na shohinnn, - bërtet gruaja me të madhe.

- Çohu, - ia këput ai, së bashku me një të rënë të pasmeve.

Të dy, burrë e grua. Turren me brekë nëpër këmbë kah dalja e arës, aty ku kufizohet me jonxhën tonë.

Në darkë nëna na kishte gatuar byrek me spinaq. Ushqimin tim të preferuar. Pasi hëngrëm darkë lexova shtatëdhjetë e një faqe nga romani “Dombi e Biri” i Çarls Dikensit. Është e mrekullueshme kur nuk i plas askujt për ty, ndërkohë që ti lexon.

II

I dashur ditar, kështu më tha im vëlla të të thërras. Edhe pse ai është më i vogël se unë, dy vjet, merr vesh më shumë se unë nga këto gjërat e të shkruarit. Ai lexon shumë, aq shumë sa babai i thotë: mos lexo shumë se do bëhesh budalla. Në fakt e kam shumë zili. Nuk ia ndien aspak për problemet që ndeshemi herë pas here në familje. Në mënyrë të përpiktë, sa herë ndodh diçka ai merr një libër dhe zë një qoshe, ulet aty dhe nuk çohet me orë të tëra si të qe një pulë e rënë në kllloçkë. Sesi do ia dalë në jetë, një Zot e di.

Më tha se herë pas here ai merr një bllok dhe shkruan ose tregon gjërat që i ndodhin në përditën tonë. Nuk i kam lexuar gjë. Edhe po deshe nuk të lejon. Megjithatë, unë po nis të shkruaj një ngjarje që dje ma zunë sytë.

Jeta në fshat ka një rutinë besnike. Secili në familje ka rolin e vet. Im atë shkon në punë çdo ditë në mëngjes dhe kthehet në darkë vonë. Me zetar bredh arë më arë duke mbjellë grurë, jonxhë, tërshërë, thekër, elb, e më së shumti misër e fasule. Ime më

zakonisht merret me punët e shtëpisë. Ajo mjel lopën, gatuan, dhe bën herë pas here ndonjë punë nëpër ara. Merret edhe me punët e kopshtit, të cilin gratë e lagjes përherë ia kanë zili. Dhe në fund ajo merret me edukimin tonë. Më saktë merrej dikur. Dy motrat merren me punët e tjera të shtëpisë; lajnë dyshemetë, marrin pluhurat, lajnë tesha, enët dhe gjithçka tjetër që bëhet pis. Unë përgjithësisht merrem me vaditjen e arave dhe me punë të tjera mbështetëse në ara. Ndërsa im vëlla dy gjëra që bën gjithmonë dhe njëkohësisht: kullot lopën, së cilës i ka vënë emrin Kuqja dhe lexon.

Meqë kisha radhën për të vaditur për herë të fundit jonxhën në tokat e Gungave, hodha shatin në krah dhe mora rrugën për në Kodrën e Vjetër dhe ktheva kanalin e ujit. U ndala e prita një copë herë derisa uji të bënte njëfarë rruge.

Kur u ktheva poshtë dhe zbrita në arat e Gungave pashë diçka që më habiti me tërësej. Nga ara jonë e misrit dolën duke vrapuar dy njerëz. Një burrë e një grua. Burri kishte veshur një bluzë ngjyrë blu, një palë çizme të gjata llastiku dhe një palë pantallona të zeza. M'u duk sikur të qe Selim Vreshi. Po me kë të ishte vallë?! Gruaja, kishte një fustan me lule të kuqe, e sfond të bardhë. Në kokë mbante një shami. Kishte një trup pak a shumë si të mamasë sime. Se dallova dot kush ishte, ngaqë sa fillova ta shoh me vëmendje, ajo kapërceu në arën e Selimit, eci përngjit porendit me lajthi; u zhduk në arat e Gjokajve. Mendova njëherë t'i ndjek, por shumë shpejt hoqa dorë.

Mbrëmja po vinte dhe duhej të kisha mbaruar së vadituri së paku njëren parcelë të jonxhës.

Pthuu, këtu e gjetën të shkërdhehen këta, në bereqetin tonë, në bukën tonë, thashë me vete, e mandej shtova me aq sa pata fuqi.

- Shkërdhatëëë!

Jehona e zërit tim u soll nëpër gropën e Shterpës dhe erdh e m'u përplas mu në fytyrë. Zëri im m'u duk aq i ngulmët e i vendosur saqë më dha një ndjenjë kënaqësie. Ndërkaq, ia kërcita apet një piskame edhe më të fortë:

- Shkërdhatë muti!

Piskama ime bëri që tek-tuk nëpër fundet e arave të qesin krye gra e burra, të cilët mblidhnin dorën e fundit të groshëve. Edhe pse larg, thirrma ime bëri njëfarë pune. Së paku krijoi dëshmitarë që panë ngjarjen.

Sikur nuk kishte misra të tjerë rrotull. Këtu në arën time e gjetën?! Pse nuk shkuan ta zëmë në arën e Selimit.

Në fakt, nuk është hera e parë që përballem me kësioj situatash. Kam parë në fakt edhe gra e burra të tjerë që shkërdhehen misrave. Djem e vajza të reja, madje disa të fejuar e të martuar. Burrat i kanë në Greqi, Itali, madje edhe në Angli. Ata shkojnë atje dhe harrohen. Gratë i lënë në fshatra, ashtu si lënë edhe makinat, që t'i përdorin kur të kthehen. Por ka një ndryshim thelbësor në këtë mes: gratë nuk janë objekte, ato janë qenie prej mishi e gjaku, prej tundimi dhe epshi. Tekefundit biologjia bën të vetën.

Ndërsa makina është prej hekurash, nëse nuk e lëviz askush ajo qëndron aty ashtu siç e ke lënë. Sidomos nëse nuk është dikush që ta ngasë. Ama gratë, gratë i ngasin të rinjtë e fshatit, burrat, e jo në pak raste edhe pleqtë. Imagjinoni pra, veç shkërdhimit të njerëzve në misra, shkërdhehet edhe demografia, morali po e po, logjika po e po, por po shkërdhehet me tërësej edhe rendi i gjërave. Në çdo fshat është e njëjta pamje. Vera i mbledh njerëzit arrave, ndërsa dimri i mbledh plevicave dhe ahureve. Veçse në Shterpë është diç më e theksuar, e këto gjëra ndodhin shumë shpesh.

- Ishin Mbarimja, e bija e Zemrekut, bashkë me Sabitin, të birin e Qenanit.

- Jo. Nuk ka mundësi. Mbarimja nuk është aq e shëndoshë.

- Si jo? Është shëndoshur kohët e fundit. Si thes është bërë.

- Po ajo nuk mban shami.

- E ka vënë që mos ta njohë kush. Quhet kamuflim. Maskim.

- Ku merr vesh ajo nga këto gjëra.

- Si nuk merr? Është në shkollë ejjj. Vazhdon gjimnazin.

- Gjimnaz leshi. Sabiti i jep mësim.

- Po de. Këtu lidhet gjëja.

- Nuk qe ajo dhe pikë.

- Kush qe pra?

- Qe Sosja.

- Cila Sose?

- Sosja e Arbenit. Me bythët si dybek.

- Me shumë vëmendje ia paske parë.
- Kjo nuk lidhet me këtë muhabet.
- Nuk është as ajo.
- Kush pra?
- E shoqja e Gëzim Tulës. Bash ajo.
- E Gëzimit?
- Bash ajo.
- Jo more. Pordhës po ia fut.
- Pse?
- Ajo është grue me namuz. Krejt mirë flasin për të.
- Po burri?
- Selimi mund të ketë qenë.
- Ku bazohesh për këtë?
- Se ai e ka arën ngjitur me Gëzimin.
- Vari leshtë kësaj pune.

Këtu nuk mund ta dëgjoja më këtë bisedë. Në kafenenë e fshatit zu të përmendej edhe emri i sime ëme. U çova dhe ika për në shtëpi. Rrugës më vinte në kokë biseda që bëhej në kafene. Sa herë më shkonte në mend përpiqesha ta harroja.

Atë natë nëna kishte gatuar byrek me spinaq, ushqimi i preferuar i tim vëllai: Artanit. Veç byrekut, si rrallë herë kishte gatuar edhe një ëmbëlsirë. Atë që unë e dua më së shumti: revani.

Ditar, është e tmerrshme të dëgjosh emrin e mamasë sate të përflitet lart e poshtë për punë kurvëlliku. Shyqyr që nuk ke një nënë, pa përndryshe flisnim. Sidoqoftë tentoj të mos e mendoj.

III

Qielli është krejt i kthjellët, edhe pse jemi gati në mes të vjeshtës. Para dy ditësh ra një shi me rrebesh, si të qe pranverë. S'e di nëse e dini, por këtu në Shterpë pranverës bie një shi i çartur. Qielli vetëton e shkrep rrufe, sa të bëhet sikur gjithë zemërimin që e ka me botën e zbraz në katundin tonë. Sigurisht Shterpës shiu mirë i bën, se toka herë pas here ka nevojë, por ka raste kur Zoti e lëshon zemërimin e vet mbi ne, domethënë mbi Shterpën. Në fund të fundit, Ai, zemërimin e ka me njerëzit e jo me tokën. Dhe fryhet mandej Drini e shtrihet përmbi fushat tona, siç shtrihet një petë krepit mbi pllakën e pjekjes. Në fakt kropa vetëm një herë kam ngrënë. Në Tiranë me disa kushërinj. Aty ua mësova edhe emrin edhe mënyrën se si gatuheshin. E fiksova mirë, atë çast kur vajza që gatuate krepat, me një vegël të vogël në një dorë të madhe, shtrinte petën e krepit, njësoj siç shtrin Zoti ujin e Drinit mbi Shterpën tonë rrëzë tij.

Dita, pra, qe e kthjellët. Nga ato ditët që shiu e ka pastruar ajrin, e bashkë me të edhe bimët, pemët,

dhe misrat. Veç t'i shihni se çfarë ngjyre kanë marrë misrat nëpër ara. Mbizotëron një ngjyrë që fillimisht duket si një e kuqe e zbehtë, por nëse përqendrohesh me shikim në të, vjen e shndërrohet në një ngjyrë ari. Sidoqoftë tash që po shkruaj, mbi ty, o blloku im me kapakë të kuq, dita është e mirë.

Para disa ditësh u ktheva vonë nga shkolla, kishim rendin e pastrimit, bashkë me shoqen time të ngushtë. Rrugës dëgjova që në arën tonë me misër kishin hyrë dy përbindështa, po de përbindështa, me dhëmbë e çataj të nxjerrë jashtë, me shputa e kthetra të mëdha, me trupa të gjatë e këmbë të stërmëdha. Nga përshkrimet që bënë vajzat e klasave të tjera, të cilat kishin edhe ato rendin e pastrimit, më bëhej sikur këta përbindëshat të ishin arinj. Se domosdo, mendoj që përbindëshi duhet t'i ngjajë një kafshe. Aq sa kam parë unë në librin e biologjisë dhe në televizor kafsha më e frikshme është ariu. Luanët, edhe pse janë të fortë, janë të bukur, ndërsa ujqit janë të vegjël. Kështu kushtet e përbindëshit i përbush vetëm një ari: i madh, i frikshëm dhe jo aq i bukur.

Vajzat thoshin se teksa mësues Sabiti po kthehej te shkolla për të marrë ditarin, që e kishte harruar në sallën e mësuesve, i kishin thënë që në arën e Tulajve, prej misrit të tyre farë njëqindnjëmbëdhjetësh, kishin dalë dy përbindështa. Këtë ia kishte thënë masandej mësueses së fizkulturës, e kjo ua kishte treguar nxënëseve të saj të bënë kujdes, që kur të ktheheshin ta kishin mendjen, e mos e linin në të harruar këtë

punën e përbindëshave. Kjo nuk është shaka, kishte thënë ajo krejt në fund.

Gjëra të çuditshme po ndodhim këto kohë. Kështu thotë edhe im atë sa herë merr në dorë pultin e televizorit.

Në shtëpi nuk gjeta askënd veç sime mëje. Ajo kishte kapur shkopin e petës dhe po tëhollte byrek.

- Me ç'po e bën mama?
- Me spinaq.
- Pse jo me lakra?
- Se kështu dua unë.
- Në rregull.
- Ndërrohu shpejt e nisja punëve.
- Patjetër.

Nuk e di pse nuk e bën atë byrek me lakra. Mua përherë ma shpif aroma e spinaqit. Kur e mendoj asnjë në shtëpi nuk e ka me shumë qejf këtë bimë jeshile të shpifur veç Artanit. Ai lë kokën pas spinaqit. Një ditë, verën e kaluar, m'u desh që të shkoj në kopsht për të shkukur disa kokrra qepë. Se ç'do gatuante mama as që e mbaj mend. Nuk është nevoja për detaje, më mjafton që ngjarjen e mbaj mend. Shkoj përmes kopshtit, kapërcej përmes domateve, që ishin rritur më shumë sesa unë, teksa hundët m'i shponte aroma e dendur e tyre. Kapërcej edhe parcelën me mollë, për të dalë te një pjesë toke e mbjellë me qepë. Ç'të shoh? Artani, kishte shkukur një dorëz spinaq dhe herë e kafshonte, herë e mbante në dorë si të ishte një kaush akullloreje.

Veç për Artanin mama e mbjell spinaqin, dhe kuptohet që veç për qejf të tij po e bën edhe këtë byrek.

Teksa po mbaronte dhe një ëmbëlsirë, që shumë rrallë e bën, e pyeta për çështjen e përbindëshave në arën tonë. Unë vetë nuk e besoja, por thashë ta pyes, mos ndoshta kishte ndodhur ndonjë gjë që lidhet ndopak me këtë temë.

Kur e pyeta, ajo fillimisht qeshi, qeshi me të madhe. Por pasi mbaroi me të qeshurat erdh e u nxi si thëngjilli. Sytë iu vrenjtën dhe vetullat i morën një formë të çuditshme.

Nuk ka asnjë përbindësh më tha. Pastaj shtoi që kanë qenë dy njerëz. Një burrë e një grua. Nusja e tënd xhaxhai së bashku me Selim Vreshin. Por kujdes më tha, mos e bëj llaf me askënd. Këtu m'u mbyll goja. Madje m'u mbyll edhe imagjinata. U përskuqa. U shastisa. Dihet se çfarë bënin ata në arën tonë. Ajo çka më habit më së shumti është ngatërresa që iu është bërë me përbindëshat. Si mund të ngatërrohen dy njerëz me dy përbindësja.

Çudi! Shterpë hesapi.

Në mbrëmje vonë prita që në shtëpi të hapej, në mos muhabeti i nuses së tim xhaxhai me Selimin, së paku muhabeti i përbindëshave. Hiç. Asgjë. Të gjithë hëngrën si të babëzitur byrek me spinaq. Sidomos Artani, tri copa të mëdha. Edhe revaninë e thanë të gjithën. Janë burra, mendova, merren me punë fizike. Unë nuk preka thuajse asgjë. Isha krejt

e mpirë, e përhumbar në arën me misër dhe prej syve nuk m'u shqit për as edhe një çast nusja e tim xhaxhai kapërthyer me Selimin aty mes barit, misrit e groshëve. Në familjen tonë nuk flitet për kështu temash.

Të nesërmen nuk durova dot më dhe i tregova motrës. Ajo është më e madhe se unë dhe merr vesh më shumë në këto çështje. Kanë qenë duke bërë seks më tha. Këtë e dija në fakt. Unë i tregova për të kuptuar diçka më shumë.

- Nuk është hera e parë që shkërdhehet lart e poshtë.

- Vërtet?!

- Pa pikë dyshimi. Do të t'i rendis unë disa raste?

- Pa hë!

- Te plevica e vet vjeshtën e kaluar; tek ara e Selimit para tre muajsh; te hauzi i ujit të Preshit mbi dy-tri herë, madje dhe në krevat të tënd xhaxhai vitin që shkoi, kur ai iku në Tiranë për tri ditë.

- Të gjitha këto i ke parë?

- Jo.

- Po sa herë i ke parë?

- Asnjëherë. Me të dëgjuar e kam.

- Nga kush?

- Jooo. Harroje. Nuk qes sekretet unë.

- Di gjë tjetër?

- Nuk është vetëm Selimi. Janë dhe disa të tjerë. Kështu flitet lart e poshtë.

Këto që dëgjova nga ime motër më mpinë gjithë sa isha. Gëzoja një respekt të fortë për nusen e tim

xhaxhai. Punonte fort sa në shtëpi e sa në arë. Këmbë më këmbë me të. Të dy tok në arë, të dy tok në shtëpi. Si mund t'ia bënte ajo këto gjëra tim xhaxhai? Ai është i vetmi burrë i mirë që i ka ngelë këtij katundi.

Kujtesa m'i përvijoi tash të gjitha imazhet e saj. Çdo herë që e kisha parë tek merrte rrugën e vetme për në Gunga. Çdo herë që e kisha parë tek shkonte e vetme te plevica. Sa e sa herë që e kisha parë të shkonte e vetme te hauzi me dy bidonë të bardhë uthulle në duar, gjoja për të mbushur ujë m'u dhanë para syve përnjëherësh. Sikur të gjitha këto imazhe kishin njëfarë nguti për t'u futur në kokën time, kush e kush të zhytej i pari. Të gjitha këto herë ajo ia paska dredhur tim xhaxhai. Madje jo vetëm me një, por me disa syresh. Tekefundit numri nuk përbën ndonjë ndryshim. Bushtërsëze, zabërhane, kurvëhane.

Ja tek bredh në bahçe. Po e shoh tek i sillet rrotull tim xhaxhai, sikur e do aq shumë, sikur ajo i është kushtuar veç atij. Nuk po e duroj dot. Nuk ecet kështu. Për një çast më shkrep një ide. Çel dritaren.

- Kurvëëë. Bushtë. Putanëëë.

Të gjitha këto i them nën zë, por që jehon e jehon brenda meje si një piskamë trimi në një majë mali.

Ju ka ndodhur ndonjëherë që t'ju fiksohet ndonjë këngë, të cilën e dëgjoni diku dhe e këndon tri ditë rresht? Kështu më ndodh mua përherë. Jo me këngët, por me imazhet. Tri ditë rresht parasysh kisha shalët e gruas së tim xhaxhai dhe me Selimin në to. Të qe ndonjë bukurosh ia kisha bërë hallall të gjitha.

IV

E kam të qartë sikur ta përjetoj në këtë çast ditën e parë të gjimnazit, kur ime më, ndër shumë porosi të tjera më tha: Nëse do më sjellësh ndonjë marre, mos u nis hiç për në shtëpi se nuk do të kesh më vend këtu. Me marre këtu në Shterpë i referohen marrëdhënieve mes një djali dhe një vajze. Pra, porosia ishte që unë të mos kisha lidhje me ndonjë djalë. Për t'i shpëtuar kësaj gjëme më ishte sugjeruar të qëndroja sa më larg djemve, të mos u jepja xhevap. Sa herë të binte rasti të përballesha me ndonjë syresh, duhej t'i bëja bisht. E zbatova këtë urdhëresë disa muaj në vit të parë aq sa situata u bë e padurueshme.

Një ditë vendosa që këshillave kërcënuese, të cilat m'i dha mama, t'u vë vizën. Ndërkaq fillova shoqëri me një djalë të klasës. Jemi bashkë që tri vite. Kam bërë çmos që ta mbaj të fshehtë këtë lidhje, por tashmë kupa është mbushur. Ka nisur të derdhet, së bashku me lotët e mi. Ku ta gjej takatin e t'i them mamës. Sa herë bie llafi i gruas së xhaxhait për kësisoj punësh, mama çakërdiset, bëhet sikur e kapin xhindet, bërtet, derisa

muhabetit i vihet kapak me një emër të përhershëm: kurva. Tash imagjinoni kur t'i them unë për veten time. Aq më tepër që porositë e saj për këtë punë kanë qenë të prera.

Në Shterpë dritat ikin thuajse përnatë dhe nuk vijnë për orë të tëra. Në fakt, në krejt luginën e Drinit, fryn erë e fortë, sidomos në vjeshtë dhe në dimër. Vëllezërit dhe motra ka disa kohë që e kanë gjetur zgjidhjen e çështjes së dritave. Ata ose luajnë letra, ose domino. Ndërkaq kur ka disa raste që atyre nuk ua kande të luajnë, dalin nga dhoma tjetër, ndezin disa qirinj dhe ulen e shkruajnë ose vizatojnë objekte në ca blloqe, të cilat na i solli në formën e një kompleti daja i vogël që jeton e punon në Greqi.

Kur i solli, ne i ndamë një për secilin. Artani, vëllai im i vogël, mori bllokun me kapak të bardhë; Tahiri mori bllokun me ngjyrë të verdhë; ndërsa Lejla mori bllokun ngjyrë të kuqe. Atë në fakt desha ta marr për vete, por si gjithmonë ndërhyu mama dhe veç iu fut kazmën gjërave. Mbaj të ziun ti, më tha, se je më e madhe. Lëre Lejlën të zgjedhë kë të dojë.

Edhe unë po shkruaj sot për së pari herë në faqet e këtij blloku. Më ndiej për mungesën e stilit o bllok, se unë e kam për herë të parë.

Zakonisht nëpër blloqe shënohen gjëra të rëndësishme, dhe duke qenë se unë nuk kam gjëra domosdoshmërisht të rëndësishme, do të shkruaj gjëra që unë i mendoj si të veçanta.

Para dy javësh Lejla, në pikë të mëngjesit, më rrëfeu një ngjarje që për mua nuk ishte e re.

Më tha se gruaja e xhaxhait, Verimja, ishte parë të dilte nga ara jonë e misrit së bashku me Selim Vreshin. Unë i rendita asaj edhe disa raste të tjera kur këta janë përleshur vend e pa vend me njëri-tjetrin, duke e lënë të kuptonte se kjo nuk është gjë e re.

Ndërkaq nga brenda më vinte të qeshja me të madhe. Të qeshja, të harboja, ngaqë ngjarja është krejt e rreme. Në fakt jo krejt. Brenda kësaj ngjarjeje ka disa të vërteta, por e vërteta, si me thënë, jo më e madhja nuk është thënë siç duhet. Vërtet që në arën tonë u përleshën atë ditë një burrë dhe një grua. Është krejt e vërtetë që burri, i cili ishte në mes të misrit tonë, është Selim Vreshi, por ajo që ishte mbërthyer me të nuk ishte nusja e tonë xhaxhai, Verimja. Ajo ishte nusja e tonë babai, thënë ndryshe mama.

U bënë ditë që mama, me të dalë Selim Vreshi me atë kalin topall prej dere, çohet dalëngadalë, shkon në plevicë, merr një shat në dorë, vesh një bluzë me mëngë të gjata, terezit mirë shaminë në kokë, kthehet nga xhami i dritares, këqyret mirë e mirë dhe nga dera e pasme e kapxhikut kapërcen kanalin e Turfullt dhe ngjitet sipër për në Gunga. Këtë skenë e kam parë disa herë dhe një ditë, pikërisht atë ditë, së cilës i referohej Lejla, vendosa ta ndjek nga pas.

I shkova shumë shpejt me leckë sallanit që kisha nisur tek po dilte mama. Vesha edhe unë një bluzë me

mëngë të gjata, s'e di pse, por mendova që mama nuk bën veprime kot, dhe dola në rrugën e Gungave.

E ndoqa nga një distancë e madhe, por pa e humbur kursesi nga sytë. Me t'u afruar tek arat tona ajo nuk u fut nga shtegu kryesor, por i ra rrotull nga ara e Selimit dhe doli në cep të misrit tonë. Ma moj ma, me shat në dorë në mes të misrit që tash duhet vjelë. Kujt mendon se po ia hedh?! Pjellës sate?! Sido që të jetë fëmija yt, çfarëdo të këqijash dhe vesesh të ketë, ka veç veset e tua.

Pasi u përhum b mama në mes të misrit pashë Selim Vreshin tek afrohej te cepi i arës. Ashtu ulur pas shkurreve të ferrave dhe degëve të lajthive, e këqyra rrafshët burrin Selim tek shkonte të punonte time më. Atëkohë mendova për tim baba, për lodhjen që kalon nga mëngjesi në darkë arë më arë, dhe fillova ta krahasoj me lodhjen që ndiente tashmë mama.

Mendova për vëllezërit dhe motrën. Dyshova në i kam të gjithë plotësisht vëllallëk. Mendova edhe për të gjorën Selimavicë, që copëtohej me shat në krah arë më arë të rriste dy fëmijët e saj. Mendova të kthehem në shtëpi dhe kur të gjithë të ishim kthyer sakaq ta plasja bombën mu në mes të odës, e ta shihja fytyrën e mamës që më jep këshilla për marrën.

Mendova, ose më saktë imagjinova tim atë tek i ngulte thonjtë në fyt mamës, dhe sakaq përfundimi im ishte që mirë do të bënte. Imagjinova sytë e vëllezërve dhe të motrës sime të vogël. Imagjinova kur ta marrin vesh në fis, në mëhallë, në Shterpë dhe

në gjithë Grykën e Drinit. Ndjeva neveri për time më.
Për fshatin, për veten, për krejt botën.

Akoma ndiej neveri për gjithçka. Nuk di me kë ta ndaj këtë barrë kaq të rëndë në shpatullat e mia. T'i them Blerimit? Si mund t'ia tregosh shkërdhatllëqet e sat ëme të dashurit tënd?! Gjenetika të penalizon më së paku. Kështu vendosa që ta shkruaj në këtë bllok me kapak të zi, këtë histori të zezë të nënës sime, të familjes, të të gjithë njerëzisë.

Edhe sonte hëngrëm byrek me spinaq.

Artani i ka fajet.

V

Prej 3 vitesh punoj në një ndër gazetatat më të mëdha në vend. E kam zgjedhur këtë profesion për dy arsye që shumë lehtë mund të përmbliidhen në një. E para, për shkak se ka njëfarë ngjasimi me letërsinë. Konkurrova dy vjet rresht në Fakultetin e Letërsisë dhe që të dyja herët mora një presh të madh. Vitin e tretë m'u desh të konkurroja për gazetari. Ndërsa arsyeja e dytë është se gazetaria është i vetmi profesion që duke shkruar mund të fitosh edhe para. Jeta e një gazetari është dinamike. Çohu në mëngjes. Fut në çantë bllokun bashkë me celularin dhe shko në mbledhjen e redaksisë. Mandej dil e pi një kafe sa me një burim, e mandej me një tjetër. Tako deputetë, ministra, këshilltarë për mediat. Shko në konferenca, në dalje publike, formulo pyetje, mbaj shënime. Bjeri qytetit cep më cep. Asnjëra ditë nuk ngjan me tjetrën.

Tirana është një vend i tmerrshëm për të jetuar. Zhurma, trafik, bori makinash, jetesë e shtrenjtë, qiratë veç vijnë e rriten. Qiraja, ky burrë nëne urban, më duket sikur i vjen data çdo ditë. Sikur na e kalëron

nënë çdo ditë të javës. Aq shpejt kalon muaji sa më bëhet sikur paguaj qira çdo mëngjes. Faturat për t'u paguar bëhen shumë shpejt grumbull. Të ishte për mua do të jetoja në Shterpë. Por ma thoni ju se si mund të bëhet karrierë letrare në grykë të Drinit? Kush do t'i lexonte atje poezitë e mia, romanet, tregimet, kritikën, analizat e mia? Ëndrrat thonë e mbajnë gjallë njeriun. Kot ia fusin. Ëndrrat e çojnë dëm njeriun.

Megjithatë jetoj. Ose më saktë jetoja. Kishte diçka të bukur që e ëmbëlsonte jetën time: A. Vreshi.

Ajo ka qenë gruaja e ëndrrave të mia, me aq sa mund të kem ëndërruar, tek e kam parë të rritet çdo ditë, flokët borë të bardhë iu shndërruan në flokë all të kuq, e kam parë se si buzët e saj të imëta erdhën e iu bënë si format e një kumbulle, asosh që rriteshin në bahçen e saj në Shterpë, e kam parë edhe sesi këmbët e saj të holla si shtizat, që gjyshja punonte leshin, erdhën e iu rrumbullakosën si të qenë trungje të lëmuara peme qershie. E kam parë çdo fazë të jetës së saj. Kam qenë aty prezent, duke u rritur bashkë me të. Fillimisht e shihja si një shoqe, ose si një njeri me të cilin kalonim kohë tek arat në Gunga, më vonë si një shoqe që edhe mund ta pëlqeja, e mandej, kur u burrërova disi, nisa ta dëshiroja. Nuk mendoja më për të veç kur kullosja lopët apo kur dilja arave të Gungave, por tash mendoja edhe kur isha në shtëpi. Kur haja, kur shkruaja, kur rrija, kur shihja televizor, kur lexoja, madje edhe kur flija, ose më saktë kur shtrihesha, sidomos kur shtrihesha. Sa herë futesha

nën jorgan e mendoja, ose e imagjinoja tek futej me mua në shtrat dhe ashtu qafuar rrinim tok të dy derisa na këpuste gjumi.

Kishte raste, sidomos në periudhën kur ajo ikte te nënëdaja, dhe unë nuk e shihja dot në arat e Gungave, jo vetëm që shtrihesha çdo darkë në jorgan me të, por më fanitej edhe në ëndrra. Vetëm kështu mund t'ia dilja mungesës që ajo më impononte kur nuk vinte në Gunga. Vetëm kur mbarova gjimnazin kuptova që e doja. Pasi ia thashë, më tregoi që edhe ajo më donte, se më kishte dashur çdo çast të jetës pasi më kishte njohur. Edhe unë i thashë të njëjtën gjë, në fakt ashtu isha ndier. Të gjitha këto i thamë natën e maturës.

Fill pas asaj vere ajo nisi studimet në Tiranë dhe e la fshatin Shterpë krejt bosh, ose së paku më dukej mua kështu. Tre vjet me radhë e mbajtëm lidhjen tonë tërhiq e mos këput. A. vinte më shpesh në Shterpë krahasuar me të shkuarat e mia në Tiranë. Kur ajo vinte fshatit i binte një bukuri, sikur gjërat merrnin kuptim, sikur edhe gurët ngjallehin, për të mos folur për pemët, plepat dhe lulet.

Kur shkova në Tiranë ajo sapo kishte mbaruar studimet dhe po niste një master për Marrëdhënie Ndërkombëtare, ndërkohë që punonte në një *Call Centre* të sapoçelur në “Qytetin Studenti”. Tashmë dashurinë tonë nuk e pengonte asgjë, se kur zhbëhet distanca, gjërat janë krejt të bëshme ngaqë distancat si ato fizike, si kuptimore, si ndijore, në mos njëherësh, dalëngadalë i sfumojnë marrëdhëniet. Distanca është

si tradhtari, ta merr kalanë nga brenda, pa kuptuar, pa u ndier, nën një heshtje që nuk ngjan si e tillë. Gjithsesi ne ishim bashkë dhe aq më bënte për të shkuarën, aq më bënte për të ardhmen. Ndërkaq e tashmja kishte marrë të gjitha kuptimet e mundshme. Isha i bindur që më mirë se kaq jeta ime nuk kish se si ndreqej, nuk kishte si të bëhej dot më mirë. Po ta kishit parë ju A. Vreshin, jo që nuk do të më gjykonit, po pa dyshim do të më jepnit të drejtë.

Për pak kohë ne të dy jetuam bashkë në një shtëpi. Njëfarë jetese klandestine, ngaqë nuk iu kishim treguar asgjë prindërve tanë, të cilët sa herë na shihnin bashkë tentonin o të na ndanin, o të na thoshin që burri ka shok burrat, gruaja ka shoqe gratë.

Kështu përmblihet me pak fjalë jeta jonë, por kurrsesi dashuria. Dashuria jonë ishte e papërshtueshme, madhështore, hyjnore, deri para një muaji kur gjithë sa përmenda u shkërmoq. Pa një, pa dy, si të mos kishim qenë.

- Dashuria, - më pat thënë njëherë A. Vreshi, - nuk varet vetëm nga ndjenjat.

- E nga se varet, - e pata pyetur unë.

- Po ja. Ka disa elemente, - më qe përgjigjur.

- Po si mund të ketë disa elemente, - pata vazhduar unë, - kur është vetëm një fillikat: dashuria?

- Nuk është aq e thjeshtë, - më qe kthyer, - duhet analizuar më thellë.

- Na e analizo, - i pata thënë, - me një bindje të mbrapshtë se ajo çka po rrihte të thoshte qe kot.

- Dashuria, - më qe kthyer ajo krejt seriozitet, - është si puna e luftës. E ke parasysh? Lufta nis krejt kot. Po ashtu nis edhe dashuria, kot. Ose më saktë, për të përdorur një fjalë më të përplotë, fillon nga diç krejt banale, nga diç krejt e rëndomtë. Pra lufta, siç dashuria, buron ose merr shkas, ose po deshe merr shtysë, veç nga një ide.

- Gjithçka në këtë botë merr shkas nga një ide, - i pata thënë unë me një ton që mund të quhet edhe përbuzës.

- Këtu qëndron e gjithë çështja, - më pati thënë. - Jam dakord me ty se gjithçka nis nga ideja, por kjo ide, domethënë ideja për ta pasur dikë, nëse flasim për dashurinë, një person, e nëse flasim për luftë, një territor, vjen e bëhet obsesion, pra diç që do ta arrish se s'bën. E kupton? Ideja, obsesioni dhe mandej vjen dashuria. I gjithë ky proces vjen natyrshëm dhe është i pashmangshëm.

- Mirë pra. Por çka po do me thanë me këtë, - e pata pyetur me një si farë ironie të buruar prej toni.

- Duro pra, se ta kthjelloj unë tashti, - më qe përveshur dhe pati vazhduar më tej. - Do të ta shpjegoj sipas analizës së marrëdhënieve ndërkombëtare. Të thashë më parë që dashuria është si lufta. Për këtë ramë dakord. Kështu, që dashuria të ekzistojë e të vazhdojë duhet që më së paku të jenë dy njerëz. Po ashtu edhe që të ekzistojë lufta duhen së paku dy palë, ose dy shtete. Në dashuri të dy personat kanë pretendime, duan të marrin e të japin, duan të zaptojnë territore te njëri-